



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

Nr. 247 Prot.

KËSHILLI

Pogradec, më 21 .01 .2021

**VENDIM**

NR. 05 , DATË 20 / 01 /2021

**“PËR DHËNIEN E BONUSIT TË QERASË PËR FAMILJET NË  
NEVOJË, NË BASHKINË POGRADEC”**

Në mbështetje të Nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr. 45/2019, Nenet 4, 7 dhe 41, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, dhe Ligjit Nr. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL “ përkatësisht :Neni 3, pika 3 ; Neni 33, pika 1 “PËR SUBVENCIONIMIN E QERASË” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI :**

1. T’i japë familjeve në nevojë Bonus Qeraje, sipas programit të Strehimit Social.

Emër	Mbiemër	Gjendja Sociale	Njësia Administrative	Fshati	Vlera e Kontratës së Qerasë	Afati i Kontratës	Totali
Albina	Jolla	Familje njëprindërore (e ve)	Velçan	Zgallë	7000	18 muaj	126000
<b>Totali :126000 lekë të reja</b>							

Tabela Nr.1

2. Kjo shumë prej 126000 (njëqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë, të mbulohet nga fondi i Emergjencave Civile në Bashkinë Pogradec.
3. Pagesa kryhet në bazë të paraqitjes së kontratave të qerasë dhe përcaktimit nga tabela Nr.1 për secilin aplikues në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës, pranë Bashkisë Pogradec.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Strehimit, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, të Bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas lajmërimit nga zyra përkatëse.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

Sotirag MANGËRI

